

SHF&SHMU “HASAN PRISHTINA” - PRISHTINË



RREGULLORE E BRENDSHME E SHKOLLËS

Në bazë të dispozitave ligjore dhe në përputhje me Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, dhe me udhëzimet administrative të MASHT-it si dhe duke u mbështetur në Rregulloren e Kuvendit të Komunës së Prishtinës të datës 03 korrik 2015, dhe pas diskutimit publik me Këshillin e Nxënësve dhe Këshillin e Prindërve, Këshilli Drejtues i SHF&SHMU "HASAN PRISHTINA", në mbledhjen e mbajtur më 05.10.2017, miratoi këtë

RREGULLORE TË BRENDSHME TË SHKOLLËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet rendi shtëpiak në SHF&SHMU "Hasan Prishtina" (në tekstin e mëtejme: Shkolla).

Neni 2

Me rendin shtëpiak në shkollë:

1. Përcaktohen rregullat dhe detyrimet e sjelljes në shkollë, në hapësirat e brendshme dhe të jashtme
2. Përcaktohen rregullat e marrëdhënieve ndërmjet nxënësve
3. Përcaktohen rregullat e marrëdhënieve reciproke ndërmjet nxënësve dhe arsimtarëve
4. Përcakton orari e punës
5. Përcaktimi i rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes nga format e papranueshme të sjelljes në shoqëri, diskriminimit, armiqësisë dhe dhunës
6. Përcaktohet mënyra sipas së cilës duhet trajtuar inventari dhe pasuria e shkollës.

Neni 3

Ky rregull vlen dhe duhet zbatohet nga të gjithë personat gjatë qëndrimit në ambientet e shkollës, si brenda ashtu edhe jashtë.

Neni 4

Me dispozitat e kësaj Rregulloreje, kujdestarët e klasave janë të obliguar që të njoftojnë nxënësit dhe prindërit respektivisht kujdestarët e tyre.

Kjo rregullore duhet të vendoset në një vend të dukshëm në hyrje të shkollës dhe në sallën e arsimtarëve.

II. RREGULLAT DHE KUSHTET E SJELLJES NË SHKOLLË, NË HAPËSIRËN E BRENDSHME DHE TË JASHTME

Neni 5

Nxënësit, punonjësit e shkollës dhe personat e tjerë mund të qëndrojnë në mjediset e shkollës gjatë orarit mësimor të shkollës, përveç rasteve të aktiviteteve të organizuara, si dhe në raste të tjera për të cilat vendos drejtorja e shkollës.

Neni 6

Në hapësirën e brendshme të shkollës dhe në oborrin e shkollës janë të ndaluara:

- promovimi dhe shitja e të gjitha produkteve që nuk janë në përputhje me qëllimet e arsimit dhe edukimit;
- shkruarja dhe dërgimi i sms mesazheve të papërshtatshme;
- abuzimi me pajisje elektronike (regjistrimi dhe shpërndarja e tyre);
- pirja e duhanit;
- mbajtja e armëve;
- shkrimi në muret dhe inventarin e shkollës;
- hedhja jashtë shportës për mbeturina e letrave, çamçakëzave etj.;
- sjellja dhe konsumimi i alkoolit dhe narkotikëve në shkollë;
- sjellja e pajisjeve dhe mjeteve që mund të shkaktojnë zjarr ose shpërthim;
- lojërat e fatit dhe të gjitha llojet e lojërave të fatit me para;
- sjellja e revistave dhe vendosja e pllakateve me përmbajtje të papërshtatshme;
- vjedhja dhe shkatërrimi i pronës së shkollës dhe të tjerëve;
- përqeshja, përrulja, rrahja dhe format tjera të abuzimit;

Nxënësit nuk kanë të drejtë të sjellin persona të huaj në shkollë pa lejen e drejtorit.

Të gjithë personave u ndalohet të sjellin kafshë në lokalet dhe mjedisin e shkollës, përveç rasteve kur kërkon eksperti dhe miratohet nga ana e drejtorit.

Neni 7

Arsimtarët dhe nxënësit janë të detyruar që të kenë qëndrim të kulturuar ndaj prindërve dhe personave tjerë që qëndrojnë në shkollë dhe duhet të kujdesen për pasurinë e shkollës si ndaj pasurisë vetanake.

Neni 8

Nxënësit mund të qëndrojnë në shkollë në kohën e caktuar sipas orarit të përcaktuar për mësim dhe dhe për forma të tjera jashtëmësimore.

Nxënësi është i detyruar të vijë në shkollë së paku dhjetë minuta para fillimit të procesit mësimor dhe duhet ta lëshojë shkollën më së voni 15 minuta pas përfundimit të procesit mësimor.

Neni 9

Nxënësi është i obliguar:

- të respektojë vlerat, rregullat dhe autoritetet e shkollës;
- të silltet në mënyrë të kulturuar gjatë qëndrimit në shkollë dhe jashtë saj;
- të parandalojë dhe të raportojë sjelljet e dhunshme;
- të mbajë të pastër klasën dhe hapësirat tjera të shkollës;
- të vjen me rregull në shkollë - i veshur në mënyrë të përshtatshme;
- pas arritjes në shkollë, të vendosin rrobat dhe gjësendet personale në vendin e caktuar për këtë qëllim – në garderobë;
- të hyjë në qetësi në klasë para fillimit të mësimit dhe përgatiten për punë;
- në rast të vonesës, të kontaktojë nxënësin ose arsimtarin kujdestar të ditës;
- me rastin e hyrjes së arsimtarit në klasë të ngriten në këmbë, dhe gjithashtu, me rastin e hyrjes në klasë të një personi tjetër duhet të ngriten në këmbë përveç nëse arsimtari i përcakton ndryshe dhe me lejen e arsimtarit duhen edhe të ulen;
- me edukatë dhe në mënyrë humane të sillen me arsimtarët dhe punëtorët e tjerë të shkollës.

Neni 10

Në shenjë për fillimin e orëve, nxënësve u kërkohet të jenë në vendet e tyre dhe të përgatisin pajisjet për mësim.

Nxënësi mund të ndryshojë vendin në klasë vetëm me lejen e kujdestarit të klasës ose një arsimtari lëndor. Në laborator nxënësit mund të shkojnë vetëm me arsimtarin e lëndës.

Neni 11

Nxënësit që vonohen deri në 10 minuta duhet të hyjnë në heshtje në klasë dhe t'i kërkojnë falje arsimtarit. Nëse një nxënës është vonuar për më shumë se 10 minuta, ai duhet të presë për orën tjetër. Çdo vonesë e paarsyeshme e nxënësve duhet të evidentohet në ditar nga arsimtari.

Neni 12

Gjatë orëve mësimore, nxënësitt nuk duhet të flasin, pëshpërisin, bërtasin, grinden apo të ecin nëpër klasë. Nxënësi i cili dëshiron të pyesë ose të tregojë diçka duhet ngritur dorën për të marrë leje. Nxënësin të cilin arsimtari i tij e ka thirrur është i detyruar të ngritet në këmbë.

Neni 13

Nxënësit nuk duhet të përdorin laptopë, telefona celularë, ose pajisje elektronike, përveç nëse arsimtari i udhëzon ndryshe. Arsimtari mund të ia konfiskojë përkohësisht nxënësit pajisjet e lartpërmendura, por është i detyruar t'ua kthejë atë ose ta thërrasë prindin në bisedë.

Neni 14

Nxënësit kanë të drejtë për një pushim të gjatë dhe për pushim të shkurtëra mes orëve të mësimit. Një pushim i shkurtë zgjat 5 minuta dhe një pushim i gjatë për 20 minuta.

Gjatë pushimeve të shkurtëra, nxënësit nuk duhet të largohen nga klasa, ndërsa gjatë pushimit të gjatë ata mund të qëndrojnë në oborrin e shkollës.

Neni 15

Në klasë, dy nxënës caktohen çdo javë kujdestarë të rinj:

Kujdestarët duhet:

- të vijnë në klasë 15 minuta para fillimit të mësimit, të kontrollojnë klasën dhe të raportojnë çdo parregullsi ose dëmtim të arsimtari kujdestar i ditës;
- të përgatisin klasën për mësim, të pastrojnë tabelën dhe të sjellin materialet dhe pajisjet mësimore sipas nevojës;
- të njoftojnë arsimtarin kujdestar të ditës për mungesën e arsimtarit në orë;
- të njoftoj arsimtarin në fillim të çdo ore mësimore mbi nxënësitt të cilët mungojnë

- të njoftoj arsimtarin kujdestar të ditës mbi gjësendet (librat, fletoret, lapsat, veshjet, stoli etj.) të gjetura në klasë;
- pas përfundimit të mësimit nxënësi kujdestar i fundit e lëshon klasën pas verifikimit paraprak të klasës, muret e dëmtuara, tavolinat, karrige dhe gjëra të tjera të inventarit për të cilat informon kujdestarin e ditës.

Neni 16

Gjatë pushimit, një nga kujdestarët duhet të jetë në klasë dhe të mbajë rregullin.

Çdo nxënës që nuk u përmbahet rregullave, nxënësi kujdestar duhet të njoftojë arsimtarin kujdestar.

Neni 17

Nxënësit kujdestarë të ditës duke u mbështetur në nenin 15 të kësaj rregulloreje përcaktohen në bazë të renditjes alfabetike.

Neni 18

Arsimtarët e shkollës dhe nxënësit duhet të ushqehen vetëm në kuzhinën e shkollës.

Është i ndaluar të ushqyerit jashtë kuzhinës në hapësira tjera të shkollës;

Para se të hyjnë në kuzhinë nxënësi është i detyruar të pastrojë duart.

Gjatë kohës së ushqyerit në kuzhinë nxënësi duhet pritur në radhë dhe në qetësi.

Pas mbarimit të ushqimit, arsimtari dhe nxënësi janë të detyruar të vendosin enët në vendin e duhur.

III. RREGULLAT MBI RAPORTET NDËRMJET NXËNËSVE

Neni 19

Në rregullat mbi raportet ndërmjet nxënësve përfshihen:

- nxënësi duhet të ofrojë ndihmë për nxënësit e tjerë të shkollës që kanë nevojë për ndihmë;
- nxënësit duhet t'u japin këshilla të përshtatshme nxënësve të tjerë në përputhje me interesat e tyre;
- nxënësit janë të detyruar të lejojnë nxënësit e tjerë të paraqesin idetë, mendimet dhe qëndrimet e tyre;
- nxënësi duhet të informojnë nxënësit e tjerë rreth ngjarjeve në shkollë;
- nxënësi nuk duhet të pengojë nxënësit e tjerë në procesin mësimor;
- nxënësit duhet të respektojnë barazinë gjinore dhe nxënësit me nevoja të veçanta;
- nxënësi mund t'i sugjeroj Këshillit të Nxënësve mbi organizimin e nxënësve në aktivitete dhe forma të ndryshme të përmbajtjeve kulturore, artistike, sportive dhe të tjera në shkollë;
- nxënësit duhet të kujdesen për nevojat e nxënësve të tjerë;
- nxënësit janë të detyruar të ndalojnë çdo formë dhune ndërmjet vete;
- nxënësit duhet të parandalojnë përqeshjen, përluljen dhe përjashtimin e nxënësve të tjerë nga rrethi shoqëror.

Neni 20

Mosmarrëveshjet ndërmjet nxënësve nuk mund të zgjidhen me dhunë dhe përlëshje fizike, fyerje, përhapjen e gënjeshtreve dhe të ngjashme.

Në rast të mosmarrëveshjeve të ndërsjella, nxënësve u kërkohet të kërkojnë ndihmën e kujdestarit të klasës ose kujdestarit të ditës.

Çdo mospërputhje me rregullat regjistrohet dhe evidentohet me shkrim, raportohet te kujdestari i klasës dhe nxënësi bartë pasojat e parapara me rregulloren e shkollës - masat kufizuese dhe masat pedagogjike.

IV. RREGULLAT MBI RAPORTET NDËRMJET NXËNËSVE DHE MËSIMDHËNËSVE

Neni 21

Nxënësitt janë të obliguar të sillen mirë dhe të respektojnë arsimtarët dhe punëtorët e tjerë të shkollës.

Nxënësit janë të obliguar të përshëndesin punonjësit e shkollës brenda dhe jashtë shkollës.

Nxënësit janë të obliguar të mirëpresin dhe përshëndesin me ngritjen në këmbë një person që hyn në klasë gjatë procesit mësimor.

Neni 22

Kur hyjnë në shkollë ose largohen nga shkolla, nxënësit duhet t'u japin përparësi të moshuarve.

Neni 23

Nxënësve mund t'u lejohet vetëm me leje që të hyjnë në sallën e arsimtarëve, në zyrën e drejtorit ose sekretarit.

Nxënësi kur hyn në një klasë ose zyrë apo laborator tjetër ku hvillohet mësimi, duhet së pari të trokasë në derë, pastaj hyn në heshtje dhe të informojë arsimtarin për arsyen e ardhjes së tij. Lejimi për hyrje mbi arsyen që ai ka ardhur mund të bëhet vetëm me miratimin e arsimtarit.

Neni 24

Ditarin e klasës mund ta bartin vetëm arsimtarët. Nxënësit nuk lejohen që të mbajnë ditarin dhe dokumentacionin tjetër shkollor. Gjithashtu, askush nuk ka të drejtë të nxjerr jashtë shkollës ditarin dhe dokumentacionin tjetër shkollor.

Arsimtarit nuk i lejohet përdorimi i telefonit celular, si dhe pajisjeve dhe aparateve të tjera të ngjashme në klasë.

Neni 25

Ndalohet ndëshkimi fizik i nxënësve si dhe largimi i nxënësve nga klasa.

Gjatë procesit mësimor arsimtarit nuk i lejohet të urdhërojë nxënësin të largohet nga klasa, por mund ta dërgojë atë te drejtori ose shërbimi i pedagogjik i shkollës për bisedë.

Arsimtari nuk duhet të dërgojë nxënës jashtë ambienteve të shkollës gjatë orëve mësimore për arsye personale.

Lejohet të dërgojë nxënës jashtë hapësirës shkollore nëse kjo është planifikuar si një aktivitet në arsimin ekstra-kurrikular ose atë terciar, për të cilin prindërit kanë dhënë pëlqimin në fillim të vitit shkollor ose gjatë vitit shkollor.

V. ORARI I PUNËS

Neni 26

Orari e punës në shkollë fillon nga ora 6 dhe përfundon në orën 21.

Neni 27

Punëtorët janë të detyruar të vijnë në punë dhe të largohen nga puna sipas orarit të punës. Drejtori do të përcaktojë mënyrën e ardhjes-vajtjes në punë.

Neni 28

Prindërit mund të bisedojnë me arsimtarët e shkollës në ditën e caktuar për prindër të marrjes ose në kohën e përcaktuar nga kujdestari i klasës ose arsimtari i lëndës.

Neni 29

Materialet mund të sillen dhe të nxirren në shkollë vetëm gjatë orarit të punës, ndërsa jashtë orarit të punës vetëm me miratimin e drejtorit.

VI. RREGULLAT MBI SIGURINË DHE MBROJTEN NGA SJELLJET DHE VEPRIMET E PAPANUESHME TË DHUNËS VERBALE DHE FIZIKE SI DHE TË FORMAVE TË NDRYSHME TË DISKRIMINIMIT

Neni 30

Punëtorët e shkollës në bashkëpunim me nxënësit janë të obliguar që të sigurojnë një qëndrim të qetë dhe të sigurtë gjatë procesit mësimor në shkollë.

Neni 31

Në shkollë kujdestarojnë arsimtarët dhe nxënësit kujdestarë sipas orarit të kujdestarisë.

Orarin dhe detyrat e arsimtarëve kujdestarë i përcakton drejtori, ndërsa orarin e kujdestarisë së nxënësve e përcakton Këshilli i Nxënësve.

Në orarin e kujdestarisë së nxënësve marrin pjesë nxënësit e klasave VI-IX.

Orari i kujdestarisë publikohet në tabelën e njoftimeve në shkollë.

Neni 32

Vendi dhe kohëzgjatja e kujdestarisë përcaktohet nga drejtori.

Kujdestaria e arsimtarëve:

- Arsimtari kujdestar vjen në shkollë 15 minuta para fillimit të procesit mësimor pavarësisht nga orari i tij personal.

Kujdestari kryesor dhe arsimtari kujdestar:

- përcakton kohën e hyrjes në ndërtesë;

- Arsimtari kujdestar i ditës duhet të jetë në korridor të shkollës, para shkollës dhe gjatë pushimit ku monitoron sjelljen e nxënësve;

- njofton stafin teknik për dëmet materiale si dhe përcjell lëvizjen e nxënësve të cilët kanë sjellje të papërshtatshme;

- mbikëqyr ecurinë e mësimdhënies normale në mungesë të drejtorit dhe stafit profesional;

- kujdeset që kujdestarët tjerë dhe nxënësit kujdestarë të kryejnë detyrën e tyre;

- organizon shkëmbimin dhe zëvendësimin e arsimtarëve të cilët mungojnë.

Neni 33

Kujdestari kryesor:

- miraton hyrjen në shkollë të prindërve dhe personave të tjerë dhe për të mban evidencë.
- siguron informacionin e nevojshëm për qytetarët.

Kujdestaria e nxënësve:

- nxënësi vjen në shkollë 15 minuta para fillimit të procesit mësimor;
- lejon hyrjen në shkollë për prindërit, kujdestarët, qytetarët dhe palët tjera;
- njoftojë qytetarët dhe palët e tjera me informacionet e nevojshme;
- përcjell palët deri te personi i kërkuar;
- ndalon prindërit në hollin e shkollës deri në fund të orës mësimore;
- për të gjitha problemet gjatë kujdestarisë njofton kujdestarin kryesor ose shërbimet të tjera profesionale;
- gjatë kujdestarisë shënon të gjitha detajet e rëndësishme në libër dhe njofton për sjelljet të papërshtatshme gjatë kujdestarisë;
- nxënësi kujdestar është i obliguar që në mënyrë të kulturuar t'i trajtojë nxënësit, prindërit, arsimtarët, qytetarët dhe palët e tjera;
- nxënësi kujdestar mban kujdestarinë deri në orën 14.00.

Sjellja e papërshtatshme e nxënësit është një shkelje serioze e Rregullores së Brendshme.

Nuk mund të kujdestarohen nxënësit të cilët:

- kanë shumë mungesa të paarsyeshme;
- ata që kanë qenë të sëmurë për një kohë të gjatë;
- ata që kanë nota të shumta negative në shumë lëndë;
- ata të cilët janë të vrazhdë në trajtimin me të rriturit;
- ata të cilëve iu janë shqiptuar masa ndëshkimore pedagogjike.

Neni 34

Nxënësi mban evidencë, në librin e kujdestarisë.

Në Librin e kujdestarisë shënohen të dhënat e specifikuara nga drejtori i shkollës.

Neni 35

Në vendin e kujdestarisë, në hyrje të shkollës dhe në një vend të dukshëm, duhet të të shënohen numrat e telefonit të policisë, zjarrfikësve, shërbimeve emergjente dhe Administratës Shtetërore për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 36

Në shkollë është e ndaluar shprehja e diskriminimit në bazë të racës ose përkatësisë etnike apo ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, anëtarësimi në organizatat qytetare, arsimin, statusin social, gjendjen martesore apo familjare, moshën, gjendja shëndetësore, paaftësia, trashëgimia gjenetike, identiteti gjinor, shprehja ose orientimi seksual. Çdokush që shpreh ndaj të tjerëve veprime të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të informojë shërbimin profesional të shkollës.

Neni 37

Në shkollë është e ndaluar çdo formë e dhunës, shprehjes së armiqësisë, intolerancës dhe sjelljeve të tjera të papërshtatshme.

Çdokush është i obliguar të paralajmërojë një person i cili me akt të paligjshëm shkel ndalimin të paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni.

Me rastin e shkeljes së rregullave, çdo punonjës kërkohet të ketë qasje individuale dhe të parandalojë ose të ndalojë sjelljen e pahijshme. Është e lejueshme të përdoren dënime që janë të përshtatshme për moshën e nxënësit, duke inkurajuar një sjellje të dëshirueshme. Dënimet mund të shkaktojnë një gjendje jo të pëlqyeshme te nxënësi, por dënimi nuk duhet të drejtohet në fyerje të personalitetit apo lëndimit trupor.

VII. RUAJTJA E INVENTARIT DHE PASURISË SHKOLLORE

Neni 38

Punëtorët që qëndrojnë në zonat e përbashkëta janë të detyruar të mbajnë pastër dhe në rregull vendin e punës dhe t'i fikin të gjitha pajisjet elektronike.

Neni 39

Arsimtarët dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë në mënyrë racionale mjetet që u ofrohen atyre nga shkolla. Çdo prishje ose dëmtim në instalimet elektrike, të furnizimit me ujë, të ngrohjes ose prishje dhe dëmtime tjera nxënësit dhe arsimtarët duhet të raportojnë tek drejtori ose sekretari.

Neni 40

Pas përfundimit të orarit të punës, punëtorët janë të detyruar të pastrojnë materialet e punës që përdorin, të mbyllin dritaret, të fikin pajisjet elektrike dhe të mbyllin sallat dhe punëtoritë.

Neni 41

Nxënësit janë të detyruar t'i ruajnë librat shkollor. materialet dhe pajisjet tjera mësimore si dhe librat e huazuar nga biblioteka janë të obliguar që t'i kthejnë me kohë.
Në rast dëmtimi nxënësi është i detyruar të kompensojë dëmin.

Neni 42

Kur largohen nga hapësira e shkollës, arsimtarët dhe nxënësit duhet të marrin gjërat e tyre.
Shkolla nuk është përgjegjëse për humbjen e gjësendeve të tjerëve nga paragrafi 1 i këtij neni gjatë qëndrimit në ambientet e shkollës.
Shkolla nuk është përgjegjëse për humbjen e parave të punëtorëve dhe nxënësve gjatë qëndrimit të tyre në hapësirën shkollore.

Neni 43

Punëtorët, arsimtarët, nxënësit dhe personat e tjerë janë përgjegjës për dëmet e shkaktura ndaj pasurisë së shkollës dhe janë të detyruar t'i kompensojnë ato.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 44

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja e brendshme e mëherëshme.

Neni 45

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në tabelën e shpalljeve të shkollës.

*Prishtinë,
Më, 05.10.2017*

DREJTORESHA
Sofie BUNJAKU

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Majlinda NUSHI